



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 644/9 prot.

Tiranë, më 30.06.2026

VENDIM

Nr. 22, datë 30.06.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Televizioni “Ora News”, përfaqësuar nga znj. (në vijim “Ankuesja”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës nr. 644 prot., datë 02.03.2026, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës datë 17.02.2026, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me “*Asgjësimin e një sasive uji të bllokuar me prani mbi normën e lejuar të ndotësit mikrobiologjik E. Koli 2, nga subjekti*”, konkretisht:

1. A e ka pranuar AKU kërkesën e subjektit për rinisje të aktivitetit?
2. Nëse po, kur e ka rinisur aktivitetin?
3. Kur subjekti ka filluar punën, a e ka asgjësuar sasinë 6800 litra ujë të ambalazhuar me prani mbi normën e lejuar të ndotësit mikrobiologjik E. Koli 2?
4. Në cilin vit, muaj, ditë është kryer asgjësimi i ujit të bllokuar?
5. Cili është emri i subjektit?
6. Lutemi na vini në dispozicion një kopje të procedurës së asgjësimit të sasisë 6800 litra ujë të ambalazhuar.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 26.02.2026, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion.

Ankuesja, pas përgjigjes së Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk i është vendosur në dispozicion informacioni i plotë, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit për pikat 5 dhe 6 të kërkesës për informacion, konkretisht: *Cili është emri i subjektit? Lutemi na vini në dispozicion një kopje të procedurës së asgjësimit të sasisë 6800 litra ujë të ambalazhuar.*

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 644/1 prot., datë 06.03.2026, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 13.03.2026.

Ankuesja, në tejkallim të afatit për kthimin e përgjigjes nga Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it të regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 644/2 prot., datë 19.03.2026, ka vijuar ankimin, duke kërkuar përmbushjen e detyrimit nga Autoriteti Publik për dhënien e informacionit të kërkuar.

Në vijim, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1221/1 prot., datë 25.03.2026, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 644/3 prot., datë 27.03.2026, ka kthyer përgjigje, duke refuzuar dhënien e informacionit për pikat 5 dhe 6 të kërkesës për informacion, duke argumentuar ndër të tjera se: *“Në analizë të kërkesës për rivlerësim të dhënies së informacionit të kërkuar, vlerësojmë se qëndrimi i mbajtur për kufizimin në dhënien e informacionit është i drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Konkretisht, informacioni i kërkuar (pikat 5 dhe 6: “Cili është emri i subjektit?” dhe “Lutem të na vini në dispozicion një kopje të procedurës së asgjësimit të sasisë 6800 litra ujë të ambalazhuar” lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë tregtare të subjektit, si dhe me veprimtarinë inspektuese e masat administrative të marra ndaj tij, në kuadër të ushtrimit të funksioneve ligjore të institucionit.*

Emri i subjektit tregtar dhe numri unik i identifikimit të tij (NUIS), ndaj të cilit janë marrë masa administrative, përbën informacion që lidhet me veprimtarinë tregtare dhe statusin ligjor, si dhe përmban të dhëna që gëzojnë mbrojtje ligjore në aspektin e konfidencialitetit tregtar dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Dhënia e këtij informacioni në formë të plotë do të cenonte interesat e ligjshme të subjektit dhe do të binte në kundërshtim me kufizimet ligjore të parashikuara.

Megjithatë, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe të transparencës së kufizuar, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vlerëson se, maksimalisht, mund të vihet në dispozicion informacion i përgjithësuar dhe i anonimizuar, konkretisht vetëm përmes inicialeve të

subjektit tregtar, pa identifikues të tjerë si NUIS, emri i plotë tregtar, adresa, apo elemente të tjera që do të mundësonin identifikimin e tij të drejtpërdrejtë. Në këto kushte, dhënia e informacionit të kërkuar në formën e plotë nuk është e mundur, ndërsa ofrimi i tij vetëm në formë të kufizuar dhe të anonimizuar përbën kufirin maksimal të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

Për sa më sipër, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vlerëson se refuzimi për dhënien e informacionit të kërkuar në formën e pretenduar është i bazuar në ligj dhe i justifikuar e, për rrjedhojë, nuk ekzistojnë kushte për rishqyrtimin apo ndryshimin e përgjigjes fillestare të dhënë nga DPAKU”.

Për këtë, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion, me Urdhrin nr. 105, datë 14.05.2026, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, duke filluar nga data 21.05.2026. Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ, i cili u protokollua me nr. 2493 prot., datë 18.05.2026.

Gjatë inspektimit u kontaktua me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, znj. Asja Lata dhe znj. Ira Allkoshaj, me detyrë përgjegjëse në Sektorin e Koordinimit të Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU), të cilat gjatë ushtrimit të inspektimit pranuan se kishin trajtuar kërkesën për informacion, si dhe rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në kthim përgjigjet e sipërcituara, nëpërmjet *e-mail-it* datë 26.02.2026 dhe shkresës kthim përgjigjeje nr. 1221/1 prot., datë 25.03.2026.

Në vijim, Autoriteti Publik, me *e-mail-in* datë 02.06.2026, ka kthyer përgjigje, duke vendosur në dispozicion informacionin për pikën 6 të kërkesës për informacion, duke kufizuar (fshirë) emrin e subjektit, me arsyetimin se: *“Në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), si dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale e sekretit tregtar, emri i subjektit dhe të dhëna të tjera personale (emrat e punonjësve, inspektorëve etj.) janë kufizuar (fshirë)”.*

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja, me anë të *e-mail-it* të administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 644/7 prot., datë 09.06.2026, ka vijuar ankimin, duke kërkuar marrjen e një vendimi lidhur me ankesën objekt shqyrtimi, detyrimin për dhënien e informacionit të plotë (emrin e subjektit) nga Autoriteti Publik.

Në këto kushte, pas ushtrimit të inspektimit pranë Autoritetit Publik, përgjigjes së këtij të fundit nëpërmjet *e-mail-it* datë 02.06.2026, Zyra e Komisionerit, me qëllim shqyrtimin e përgjegjësisë në trajtimin e kërkesës për informacion sipas parashikimeve të LDI-së dhe marrjes së një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”,* bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, çmoi të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 22.06.2026, në prani të znj. Asja Lata, koordinatorë për të drejtën e informimit dhe specialiste në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme dhe znj. Ira Allkoshaj, përgjegjëse në Sektorin e Koordinimit të Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në cilësinë e personave që kishin trajtuar kërkesën/ankesën.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në kthim përgjigjet e sipërcituara, si dhe pranuan se ishin në dijeni të vendim-urdhërimit nr. 16, datë 14.05.2026, të Komisionerit ndaj Autoritetit Publik.

Në përfundim të seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Autoritetit Publik konfirmuan se ishin personat përgjegjës që kishin trajtuar ankesën, si dhe bazuar në sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore Autoritetit Publik iu la afat të rishikonte qëndrimin e mbajtur, brenda ditës, më datë 22.06.2026.

Në kalim të afatit të vendosur gjatë seancës dëgjimore, Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 25.06.2026, ka kthyer përgjigje, duke bërë me dije, ndër të tjera, se: “... rezulton se subjekti i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt “Anulim vendimi (akti administrativ) të palës së paditur, Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Elbasan”. Po kështu, rezulton se në përfundim të gjykimit të çështjes në shkallë të parë, Gjykata ka vendosur: “1. Mospranimin e padisë [...]”.

Megjithatë, ende nuk ka asnjë njoftim nga ana e gjykatës nëse vendimi i lartpërmendur ka marrë formë të prerë, apo nëse paditësi (subjekti) ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit”.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: “*“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj.*” Në kuptim të këtij parashikimi, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundur realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: “1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”

Sqarojmë se LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë* dhe 2) *informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar*. Në kategorinë e parë përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoriteti Publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, ndërsa rasti konkret, objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, që përfshin ato informacione, për njohjen e të cilave është e nevojshme të paraqitet një kërkesë për informim pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI-së, detyrim të cilin Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur.

Lidhur me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik se: *“Emri i subjektit tregtar dhe numri unik i identifikimit të tij (NUIS), ndaj të cilit janë marrë masa administrative, përbën informacion që lidhet me veprimtarinë tregtare dhe statusin ligjor, si dhe përmban të dhëna që gëzojnë mbrojtje ligjore në aspektin e konfidencialitetit tregtar dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi”*, Komisioneri vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi informacioni i kërkuar lidhet ngushtësisht me sigurinë ushqimore dhe shëndetin, si rrjedhojë dhënia e tij paraqet interes të lartë publik. Konstatohet se Autoriteti Publik, në argumentin e parashtruar për mosdhënie të informacionit, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, si dhe dëmin që mund t’u shkaktojë subjektit tregtar, si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar.

Po ashtu, bazuar në pikën 23 të nenit 5 të ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, *Subjekt i të dhënave* është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror. Në këtë kuadër, emrat e subjekteve të regjistruara si person fizik ose juridik, në bazë të legjislacionit përkatës tregtar, nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj.

Ndërkohë, referuar pretendimeve mbi mbrojtjen e sekretit tregtar, sillet në vëmendje se neni 2, pika 3/1 e LDI-së ka përcaktuar përkufizimin e sekretit tregtar, duke i dhënë atij të njëjtin kuptim që i ka dhënë ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 *“Për pronësinë industriale”*, i ndryshuar. Konkretisht, në nenin 111/a të tij parashikohet se:

“1. “Sekreti tregtar” është informacioni që përmbush kërkesat e mëposhtme:

- a) është sekret në kuptimin që në tërësinë e tij ose për sa i përket konfigurimit të saktë dhe kombinimit të pjesëve përbërëse të tij, nuk është gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë;*
- b) ka vlerë tregtare, sepse është sekret;*
- c) u është nënshtruar hapave të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit, sipas rrethanave, nga personi që zotëron në mënyrë të ligjshme informacionin për të mbajtur sekretin të fshehtë.*

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, me informacion dhe hapa të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit do të kuptojmë:

a) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni përfshin, ndër të tjera, njohuritë teknike, informacionet për shoqërinë tregtare dhe informacionet teknologjike;

b) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni ka vlerë tregtare, ndër të tjera, në ato raste kur përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e paligjshme e sekretit tregtar ka mundësi të dëmtojë interesat e personit që kontrollon në mënyrë të ligjshme këtë sekret tregtar, duke cenuar potencialin e tij shkencor dhe teknik, interesat financiare të shoqërisë tregtare, pozicionet strategjike ose mundësinë për të konkurruar;

c) hapat e arsyeshëm të referuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni mund të përfshijnë përgatitjen e një akti të brendshëm për administrimin e një sekretit tregtar dhe grupin përkatës të personave, që është përgjegjës për administrimin e tij apo masat për mbrojtjen fizike ose virtuale në aksesin e administrimin e sekretit tregtar.

3. “Mbajtës i sekretit tregtar” është çdo person fizik ose juridik që zotëron në mënyrë të ligjshme një sekret tregtar.”

Ndërsa, në nenin 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, është përcaktuar qartë kufiri i sekretit tregtar, i cili përfshin vetëm informacionin e brendshëm. Megjithatë, në pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji parashikohet se: “2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik”.

Për sa i përket argumentit të parashtruar nga Autoriteti Publik se: “... rezulton se subjekti i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt “Anulim vendimi (akti administrativ) të palës së paditur, Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Elbasan”. Po kështu, rezulton se në përfundim të gjykimit të çështjes në shkallë të parë, Gjykata ka vendosur: “1. Mospranimin e padisë [...]”. Megjithatë, ende nuk ka asnjë njoftim nga ana e gjykatës nëse vendimi i lartpërmendur ka marrë formë të prerë, apo nëse paditësi (subjekti) ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit”, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron.

Sqarojmë se LDI, në nenin 17, parashikon rastet kur e drejta për informim kufizohet, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Bazuar në shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 17 të LDI-së, parashikohet se: “E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ç) në mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike”. Në këtë kuptim, kufizimi i informacionit synon mbrojtjen e hetimeve administrative ose procedurave administrative që janë ende në proces dhe që mund të cenohet nga dhënia e informacionit. Në rastin konkret, procedura administrative ka përfunduar tashmë me vendosjen e sanksionit administrativ.

Ndërkohë, kufizimi sipas shkronjës “dh” të pikës 2 të nenit të sipërcituar, sipas të cilit: “E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit

gjqësor”, lidhet me garantimin e zhvillimit të rregullt të procesit dhe mbrojtjen e të drejtave procedurale të palëve në këtë proces. Në rastin tonë, objekti i ankimit në gjykatë “Anulim vendimi (akti administrativ) të palës së paditur, Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Elbasan”, nuk përputhet me objektin e kërkesës për informacion, objekt ankimi, pranë Zyrës së Komisionerit dhe ankuesja nuk është palë në këtë proces. Rrjedhimisht në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se argumenti i Autoritetit Publik nuk gjen zbatim, bazuar në shkronjat “ç” dhe “dh” të pikës 2 të nenit 17 të LDI-së.

Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment se në cilën pikë të nenit 17 të LDI-së e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Për rrjedhojë, në mungesë të argumentimit mbi një dispozitë të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, Komisioneri vlerëson se ekzistenca e informacionit/dokumentacionit, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Po ashtu, theksojmë se Zyra e Komisionerit për rast të ngjashëm, me vendimin nr. 16, datë 14.05.2026, ka urdhëruar Autoritetin Publik për dhënie të informacionit, ndaj mosdhënia e informacionit në rastin konkret përbën qëndrim të përsëritur nga Autoriteti Publik, duke mos respektuar në vazhdimësi detyrimet që burojnë nga LDI.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore për marrjen e përgjegjësisë së trajtimit të ankesës, Komisioneri konstaton se znj. Asja Lata, koordinatore për të drejtën e informimit, si dhe specialiste në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme dhe znj. Ira Allkoshaj, me detyrë përgjegjëse në Sektorin e Koordinimit të Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU) pranë Autoritetit Publik, janë personat përgjegjës, të cilat nuk kanë përmbushur detyrimin për kthimin e përgjigjes së kërkesës për informacion, rrjedhimisht kanë refuzuar dhënien e informacionit.

Në këto kushte, bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të LDI-së, *refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, e cila varion nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 300.000 (treqind mijë) lekë.*

Gjithashtu, kërkesja/ankuesja është gazetareske, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë” vlerësoi se pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të

realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

Në përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së znj. _____, me nr. 644 prot., datë 02.03.2026, ndaj Autoritetit Publik, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”;
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit për pikën 5 të kërkesës për informacion datë 17.02.2026, konkretisht: *“5. Cili është emrin e subjektit?”*, brenda datës _____.____.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2024 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
3. Dënimin e znj. Asja Lata, me detyrë specialiste në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë shlyhet me këste mujore, bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoka ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar. Në tejkallim të afatit të përmendur, sanksioni administrativ përbën titull ekzekutiv;
4. Dënimin e znj. Ira Allkoshaj, me detyrë përgjegjëse në Sektorin e Koordinimit të Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU), në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e

informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë shlyhet me këste mujore, bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar. Në tejkalim të afatit të përmendur, sanksioni administrativ përbën titull ekzekutiv;

5. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, pala ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
6. Kundër vendimmarrjes në pikat 3 dhe 4, personat ndaj të cilëve është vendosur sanksioni administrativ, kanë të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të këtij vendimi në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Ankimi paraqitet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
7. Ky vendim u shpall sot, më datë 30.06.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi